



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 3 qershor 2024  
Nr. Ref.: RK 2440/24

## VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

**rastin nr. KI119/23**

Parashtrues

**Adem Peci**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar të autoritetit publik**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Adem Peci, nga Republika e Shqipërisë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e akteve të paspecifikuara të autoriteteve publike.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së akteve të paspecifikuara të autoriteteve publike. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) pretendon se i janë cenuar përmes ndonjë akti të një autoriteti publik.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] neni 54 [Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 29 maj 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) e pranoi më 31 maj 2023.
6. Më 8 qershor 2023, 2023, Kryetarja përmes Vendimit [Nr. GJR. KSH. KI119/23] caktoi gjyqtarin Enver Peci gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KI119/23] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese) Bajram Ljatifi dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
7. Më 14 qershor 2023, parashtruesi i kërkesës përmes një shkrese informoi Gjykatën se ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë lidhur me rastin e tij dhe se është në pritje të epilogut.
8. Më 26 qershor 2023, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që (i) të plotësojë formularin e kërkesës duke specifikuar saktë se cilin vendim të autoritetit publik konkretisht e konteston para Gjykatës; (ii) të specifikojë cilat të drejta dhe liri janë cenuar dhe (iii) të dorëzojë vendimin e fundit të kontestuar së bashku me vendimet tjera apo dokumentet e nevojshme që kanë të bëjnë me kërkesën e paraqitur.
9. Deri në këtë datë, parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar në Gjykatë ndonjë dokument tjetër në mbështetje të kërkesës së tij.
10. Më 29 prill 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

## **Përmbledhja e fakteve të rastit**

11. Sipas pohimeve të parashtruesit të kërkesës të reflektuara në kërkesën e dorëzuar, rezulton se në periudhën nga 22 marsi 1999 deri më 13 qershor 1999, parashtruesi ka transportuar armë në Kosovë së bashku me 42 ushtarë dhe komandantë të UÇK-së.

12. Parashtruesi i kërkesës përmes kërkesës se tij të dorëzuar pohon se në nëntor të vitit 2017, Qeveria e Republikës së Kosovës i dhuroi parashtruesit të kërkesës titullin "Veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës" dhe një pension prej 170 eurosh në muaj.
13. Sipas parashtruesit, në qershor të vitit 2021 i është hequr titulli i veteranit të UÇK-së.
14. Gjykata nuk ka njohuri tjera lidhur me faktet e rastit konkret.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

15. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës thekson, ndër të tjera, si në vijim: *"Kërkoj nga ana juaj zgjidhjen e kësaj padrejtësie që na ka bërë shteti shqiptar..."*

### **Dispozitat relevante të Ligjit dhe Rregullores së punës**

#### **Ligji**

Neni 48  
(Saktësimi i kërkesës)

*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.*

#### **Rregullorja e punës**

Rregulli 25  
(Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve)

[...]

2) *Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:*

*h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.*

Rregulli 54  
(Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

*"54 (2) Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është jo e plotë ose e paqartë përkundër kërkesës ose kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën; [...]"*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

16. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës. Në këtë drejtim, sipas paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, Gjykata vendos vetëm për rastet e ngritura para

Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Ndërsa, sipas paragrafit 7 i të njëjtit nen të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

17. Përtej kritereve të përcaktuara më lart, në vlerësimin nëse parashtruesi i kërkesës i plotëson kriteret për vlerësimin e kërkesës së tij, Gjykata rikujton se neni 48 (Saktësimi i kërkesës) i Ligjit, specifikisht detyron parashtruesit e kërkesave të qartësojnë saktësisht aktin konkret të autoritetit publik të cilin e kontestojnë dhe të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri kushtetuese pretendojnë të jenë cenuar. Ndërsa, rregulli 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) i Rregullores së punës parasheh që kërkesa e parashtruesve duhet të përmbajë: (a) emrin dhe adresën e palës që parashtron kërkesën; (b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit/es për dorëzimin e dokumenteve, nëse ka; (c) autorizimin për përfaqësim; (d) emrin dhe adresën e palës, ose të palëve kundërshtarë, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet; (e) mbrojtjen juridike të kërkuar; (f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve; (g) arsyetimin rreth pranueshmërisë dhe meritave të kërkesës; dhe (h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.
18. Në këtë kontekst, sipas paragrafit 4 të nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit, që parasheh se nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Atëherë, kur palët përkatëse, nuk dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Gjykatë, bazuar në rregullin 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, duke marrë parasysh që kërkesa është e paplotë ose e paqartë, përkundër kërkesave të saj ndaj palës që të plotësojë apo qartësojë të njëjtën.
19. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se kërkesën e parashtruesit të kërkesës e kishte pranuar më 31 maj 2023. Duke marrë parasysh që kërkesa nuk ishte e kompletuar, më 26 qershor 2023, në pajtim me paragrafin 4, të nenit 22 të Ligjit, Gjykata i kërkoi parashtruesit të kërkesës që (i) të plotësojë formularin e kërkesës duke specifikuar saktë se cilin vendim të autoritetit publik konkretisht e konteston para Gjykatës; (ii) të specifikojë cilat të drejta dhe liri janë cenuar; dhe (iii) të dorëzojë vendimin e fundit të kontestuar së bashku me vendimet tjera apo dokumentet e nevojshme që kanë të bëjnë me kërkesën e paraqitur.
20. Më 14 qershor 2023, parashtruesi i kërkesës përmes një shkresë informoi Gjykatën se lidhur me rastin e tij ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
21. Gjykata vëren se edhe pas kësaj date, parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar ndonjë shkresë tjetër në mbështetje të kërkesës së tij.
22. Gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret, kërkesa e parashtruesit është e paqartë; (i) cilin akt të autoritetit publik parashtruesi i kërkesës e konteston para Gjykatës; (ii) cilat janë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për cenimin e të drejtave dhe lirive të tij kushtetuese; dhe (iii) bazuar në shkresat e lëndës dhe përmbajtjen e tyre, faktet e rastit janë të pakuptueshme.
23. Në këtë aspekt, dhe duke marrë parasysh atë që është cekur më lart, Gjykata në bazë të Rregullores së saj të punës, mund të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër, meqë parashtruesi i kërkesës nuk ka adresuar kërkesat e Gjykatës edhe pas kërkesës specifike të saj.

24. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesave, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesave nuk i përgjigjen kërkesës së Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata i deklaron këto kërkesa si të paqarta dhe jo të plota, dhe si rezultat nuk i shqyrton pretendimet e parashtruesve të kërkesave (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, [KI121/21](#), parashtrues *Bajram Hasani*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 23 shtatorit 2021, paragrafi 38; [KI135/21](#) *Isuf Musliu*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 10 shtatorit 2021, paragrafi 35; dhe [KI101/21](#), *N.T.SH. Morina B*”, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 8 shtatorit 2021, paragrafi 36).
25. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të moskompletimit të saj me dokumentacion mbështetës, ashtu siç kërkohet me nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 26 (3) dhe 54 (2) të Rregullores së punës. Prandaj, Gjykata përfundon se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 27 dhe 48 të Ligjit si dhe rregullin 54 të Rregullores së punës, më 29 prill 2024, njëzëri

### VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Enver Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

